



Prishtinë

NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH. A.
 GJP "AUTOBUSKA STANICA" A. D.
 MPE "BUS STATION" J. S.

Nr. 04/749 Data 22.04.2021
 No. _____ Date _____
 PRISHTINË/A

Stacioni i Autobusëve




PRISHTINA



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINË
 GJP "AUTOBUSKA STANICA" A.D. PRISTINA
 MPE "BUS STATION" J.S. PRISTINA

Raporti Vjetor
 NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A.
 Prishtinë

Periudha Janar – Dhjetor 2020



Prishtinë, Prill 2021

Përmbajtja

1 Informata të përgjithshme	3
2 Përmbledhje ekzekutive.....	4
3 Prezantimi.....	5
5 Financat.....	7
5.1 Të hyrat.....	8
5.2 Shpenzimet.....	8
5.2.1. Shpenzimet për paga dhe mëditje	9
5.2.2 Shpenzime operative.....	9
5.2.3. Shpenzime Administrative	10
5.2.4. Shpenzimet Investive	11
5.2.5. Shpenzimet e amortizimit	11
5.2.6. Fitimi (Humbja) para fitimit.....	11
6 Çështjet juridike	12
8 Shërbimi i transportit dhe shërbimi teknik	13
8.1 Shërbimi i transportit	13
8.2 Shërbimi Teknik	13
9 Shërbimi i sigurimit fizik aseteve dhe i laurave	14
10 Prokurimi	14
11 Digjitalizimi dhe TI-ja.....	15
12 Marrëdhëniet me publikun	16
13 Të arriturat në bazë të objektivave dhe planifikimet	17
Objektivi 1. Shtimi i të hyrave për 20%	17
Objektivi 2. Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve ekzistuese në stacion	17
Objektivi 3. Sigurimi i investimeve	18
Objektivi 4. Investimi në ngritjen e kapaciteteve të stafit.....	19
14 Auditimi.....	19
14.1 Auditimi i Brendshëm	19
14.2 Auditimi i Jashtëm	20
Shtojca 1: Organogrami	21
Shtojca 2: Çështjet Juridike.....	22
Shtojca 3: Kontratat e prokurimit 2020	23
Shtojca 4: Publikimet nga ZMP	25

1 Informata të përgjithshme

Emri i ndërmarrjes:	NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a. Prishtinë										
Shkurtesa:	SAP										
Pronar:	Kuvendi Komunal i Prishtinës										
Komisioni i aksionarëve:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Muhedin Nushi 2. Rifat Deri 3. Mirsad Vitia 										
Bordi i drejtoreve:	<table style="width: 100%; border: none;"> <tr> <td style="width: 60%;">1. Faton Raci</td> <td style="width: 40%;">– Kryesues</td> </tr> <tr> <td>2. Anita Morina Saraci</td> <td>– Anëtarë</td> </tr> <tr> <td>3. Aferdita Sylja Ismajli</td> <td>– Anëtarë</td> </tr> <tr> <td>4. Fatmir Miftari</td> <td>– Anëtarë</td> </tr> <tr> <td>5. Luan Hoti</td> <td>– Kryeshef Ekzekutiv</td> </tr> </table>	1. Faton Raci	– Kryesues	2. Anita Morina Saraci	– Anëtarë	3. Aferdita Sylja Ismajli	– Anëtarë	4. Fatmir Miftari	– Anëtarë	5. Luan Hoti	– Kryeshef Ekzekutiv
1. Faton Raci	– Kryesues										
2. Anita Morina Saraci	– Anëtarë										
3. Aferdita Sylja Ismajli	– Anëtarë										
4. Fatmir Miftari	– Anëtarë										
5. Luan Hoti	– Kryeshef Ekzekutiv										
Kapitali i ndërmarrjes:	11,271,735.84 €										
Hapësira/ha:	8.24 ha										
Numri i peronave:	24										
Numri i hapësirave afariste:	33										
Buxheti i planifikuar për 2020:	1,106,406.48€										
Te hyrat për vitin 2020:	755,662.83€										
Subvencione	160,000.00€										
Shpenzimet për vitin 2020	964,471.56€										
Racio e shpenzimeve:	Paga: 82% Kosto operative dhe administrative: 8% Investimet: 1% Kosto e Amortizimit 8%										
Numri i punëtoreve:	95 (4 pensionim) ne total me 31.12.2020, 91 punëtore										
Mosha mesatare:	44.84										
Balanci gjinor:	66 meshkuj / 29 femra.										
Ueb & domain	www.sap-rks.com										

2 Përmbledhje ekzekutive

NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a. Prishtinë është ndërmarrje publike komunale e cila me shërbimet e ofruara ka rendësi të posaçme, që përpos që bënë lidhjen e kryeqytetit të vendit tonë me pika të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, paraqet edhe një pasqyrë të rëndësishme jo vetëm të qytetit të Prishtinës por edhe të Republikës së Kosovës në të gjitha aspektet duke filluar atë kulturor, funksional etj.

Bazuar ne skemën organizative gjatë vitit 2020 kane qene të punësuar 95 punëtorë, prej tyre 66 meshkuj dhe 29 femra me një moshe mesatare prej 44.84 vitesh. struktura organizative e ndërmarrjes është e ndare ne tetë (8), departamente-sektore

Gjatë vitit 2020, është shënuar vetëm një punësim lidhur me angazhimin e zyrtarit për auditim të brendshëm dhe janë pensionuar 4 punëtorëve. Viti 2021 ka filluar me 91 punëtorë të angazhuar.

Ndërmarrja realizon të hyra vetanake dhe nuk varet nga buxheti komunal. Burimet kryesore të hyrave janë shërbimi i peronizimit (pranimi dhe përcjellja e autobusëve), shërbimi i shitjes së biletave për operatorët e transportit, shërbimi i ruajtjes së bagazhit të udhëtarëve, shërbimi i parkingut, shërbimi i poligoneve për auto shkolla, qiradhënia e lokaleve afaristë në pronësi të Stacionit.

Ne total gjatë vitit janë krijuar 755,662.83€ të hyra, qe ne krahasim me vitin paraprak janë 26% me pak. Kjo ulje e të hyrave është si pasoje e situatës pandemike ne vend, ku ndërmarrja nuk ka funksionuar ne periudhën 13 Mars deri me 18 Maj kur kane rifilluar disa linja transportuese ndërsa nga 1 Qershori ka filluar operimin me kapacitet të plotë.

Edhe pse ka qene një vit mjaft i vështire, menaxhmenti ka menaxhuar situatën duke i mbajtur shpenzimet nen kontrolle rigoroze. Ne krahasim me vitin paraprak kemi ulje të shpenzimeve ne paga prej 5%, ulje të shpenzimeve operative 56% dhe ato administrative ne mase prej 36%.

Me qellim të mbulimit të shpenzimeve për paga dhe shpenzimet tjera, ndërmarrja ka qene përfituese e dy grantëve nga Kuvendi Komunal ne vlere prej 160,000€.

Është bere një investim shume i rëndësishëm ne ndarjen e njehsorëve të rrymës ne fillim të vitit i cili investim ka ndihmuar qe të menaxhohen me lehtë shpenzimet lidhur me energjinë elektrike si dhe evitimin e ndonjë keqpërdorim eventual. Me këtë veprim shumica e bizneseve ne mënyre direkte i kryejnë obligimet ne mënyre individuale.

Gjatë vitit të kaluar, Zyra e Prokurimit ka zhvilluar gjithsej 34 procedura dhe aktivitete të prokurimit, me vlerë të përgjithshme prej 50,646.32 eurove. Prej tyre ishin njëzet e një (21) aktivitete me vlera minimale, ne shumen totale prej 14,301.42 eurove, gjashtë (6) me vlera të vogla, ne vlere të përgjithshme prej 13,541.20 euro dhe një (1) me vlera të mesme, me vlere të përgjithshme prej 11,760.00 euro.

Gjatë vitit 2020, ndërmarrja ka operuar me një humbje prej 48,808.73€. Këtë humbje e krijojnë shpenzimi i Zhvlerësimit qe paraqitet në shumë prej 79,479€, ndërsa nëse llogaritet vetëm shpenzimet dhe të hyrat operationale dhe subvencionet, atëherë gjatë vitit 2020 është shënuar një fitim operativ në vlerë prej 30,671€. Pra është viti i dytë me radhe qe ndërmarrja operon me një fitim operativ.

Gjatë periudhës të vitit 2020 janë realizuar ne total 99,583 nisje, ku prej tyre 86,252, apo 87 % kane qene nisje të linjave nder-urbane dhe 13,331 apo 13% të linjave ndërkombëtare. Edhe ne këtë rast si pasoje e pandemisë kemi rënie të linjave të mbajtura ne masën prej rreth 30%.

3 Prezantimi

Ky raport vjetor bazohet ne Ligjin mbi ndërmarrjet publike nr. 03-L-087, nenin 31, pika 31.3, ku qartë përshkruhet se brenda 45 ditëve pas përfundimit të çdo viti kalendarik, Zyrtarët e NP-së, në përputhje me Nenin 14.1, do të përgatisin dhe dorëzojnë Bordit të Drejtorëve të NP-së, një raport vjetor për vitin kalendarik të sapo përfunduar, në të cilin përshkruhen veprimet e marra, rezultatet financiare të arritura si dhe efektshmeria e përgjithshme në realizimin e caqeve të vendosura në Planin e Biznesit.

Prandaj bazuar ne detyrimet dhe përgjegjshmëritë të cilat rrjedhin nga ligji mbi ndërmarrjet publike ky raport, prezanton ne mënyre të qartë të gjitha veprimet e ndërmarra nga ana e menaxhmentit të ndërmarrjes ne realizimin e objektivave të parashtruara gjatë vitit të kaluar, respektivisht vitit 2020.

Ky raport do të prezantoje strukturën organizative të ndërmarrjes, e cila pjese paraqet pjesën me të vlefshme të ndërmarrjes, ku dihet qe burimet njerëzore janë aset kryesor i çdo ndërmarrjes sepse pa këto burime shume vështire do të mund të realizohen të gjitha synimet e planifikuara respektivisht objektivat e planifikuara me qellim qe ndërmarrja të ketë një sukses të synuar.

Performanca afaristë dhe financiare e ndërmarrjes janë dy parakushtet kryesore lidhur me suksesin e gjithmbarshëm të ndërmarrjes. Prandaj edhe kjo pjese do të paraqitet ne mënyre të detajuar lidhur me të gjitha informacionet sa i përket të hyrave, shpenzimeve dhe bilancin përfundimtar të sukses gjatë vitit 2020.

Çështjet juridike kane rëndësi të veçantë për ndërmarrjen, si rrjedhojë të njëjtat kane ndikim të madh ne suksesin e ndërmarrjes prandaj do të behet prezantimi i të gjitha veprimeve të ndërmarra qe ndërmarrja të operoje ne nje ambient sa me të mire të punës duke u bazuar ne ligjet dhe rregulloret ne fuqi.

4 Pasqyra e strukturës organizative e ndërmarrjes

4.1 Informacion i përgjithshëm lidhur me burimet njerëzore ne ndërmarrje

NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a. Prishtine, ka Bordin Drejtues (BD), ne kuadër të cilit vepron edhe Komisioni i Auditimit të zgjedhur nga komuna e Prishtinës, e cila është aksionar i ndërmarrjes, Kryeshefin Ekzekutiv (KE), Sekretarin, Zyrtarin Kryesore Financiar dhe të Thesarit (ZKFTH) të zgjedhur nga BD-ja si dhe Zyrtarin e Auditimit të Brendshëm (ZAB) të zgjedhur nga komisioni i auditimit.

Bazuar ne skemën organizative gjatë vitit 2020 kane qene të punësuar 95 punëtorë, prej tyre 66 meshkuj dhe 29 femra me një moshe mesatare prej 44.84 vitesh.

Bazuar ne Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, të datës 17.05.2019, me numër protokolli 02/693, struktura organizative e ndërmarrjes është e ndare ne tetë (8), departamente- sektorë:

1. Stafi mbështetës i KE-se;
2. Departamenti Administrativo – Juridik;
3. Departamenti ekonomik – financiar, i përberë nga shërbimi i kontabilitetit dhe shërbimi financiar – pagesave;
4. Zyra e Prokurimit;
5. Departamenti i transportit dhe shërbimit teknik i përberë nga shërbimi i transportit dhe shërbimi teknik;
6. Sektori i digjitalizimit dhe Ti-së
7. Sektori i Marketingut dhe Shitjes
8. Zyra për Marrëdhënie me Publikun

Struktura organizative e ndërmarrjes – organogrami është paraqitur ne shtojcën nr 1.

4.2 Lëvizjet e stafit gjatë vitit 2020

Punësimet - Gjatë vitit 2020, është zhvilluar procedura e rekrutimit nga ana e Komisionit të auditimit për përzgjedhjen e Zyrtarit për Auditim të Brendshëm. Gjatë këtij procesi si kandidat me i mire për këtë pozitë është përzgjedhur z. Lorik Beqaj.

Është bërë vazhdimi i një kontratë të punës për një punëtor i cili ka qenë në periudhën provuese, dhe pas një performance të shkëlqyer të treguar gjatë kësaj periudhe iu është vazhduar marrëdhënia e punës për një afat të pacaktuar.

Gjatë vitit të kaluar ka qene e angazhuar një praktikantë e cila ka qene e përcaktuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ne bashkëpunim me Komunën e Prishtinës.

Bazuar ne rregulloren për organizimin e brendshëm të ndërmarrjes sonë, meqenëse kane qene të evidentuara 4 pozita vakantë e për të cilat ka qene mese e domosdoshme të plotësohen me punëtor, është shpallur konkurs i brendshëm gjithmonë duke u bazuar dhe respektuar legjislacionin ne fuqi, duke ju dhënë kështu mundësi të barabartë për të konkurruar të gjithë punëtorët e ndërmarrjes.

Pensionimet: Si rezultat i arritjes së moshës së pleqërisë, gjatë kësaj periudhe kemi pasur 4 pensionime të punëtorëve sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Suspendim: Si rezultat i shkeljeve të detyrave të punës dy punëtorë të Ndërmarrjes janë suspenduar gjatë vitit 2020 dhe është bërë një degradim i vendit të punës për shkak të shkeljeve të detyrave të punës.

Pushimet: Gjatë kësaj periudhe kohore të gjitha pushimet vjetore janë realizuar sipas kërkesave të punëtorëve dhe aprovimit dhe planifikimit të mbikëqyrësve të tyre në bashkëpunim me zyrën e Burimeve Njerëzore.

Për shkak të gjendjes se krijuar pandemike (COVID -19), bazuar ne rekomandimet e Qeverise se Kosovës ne kuadër të masave anticovid, ndërmarrja jone ka liruar me pagese të plotë punëtorët, të cilët vuajnë nga sëmundjet kronike, punëtorët mbi moshën 60 vjeçare, gratë shtatzëna si dhe nenat me fëmije të vegjël nen moshën 10 vjeçare për shkak të mbylljes se shkollave dhe çerdheve, gjithnjë në dinamikë dhe përputhshmëri me ndërrimin e masave qeveritare.

Qe nga fillimi i pandemisë Covid-19, ne vendin tone e rrjedhimisht edhe ne ndërmarrjen tone qe nga muaji mars 2020 e gjere ne fund të vitit, janë shënuar 15 raste pozitive, 24 punëtorë kane qene persona kontakti dhe 2 punëtorë të cilët kane qene të dyshuar se kane qene të infektuar.

Sfidat gjatë vitit 2020

Gjatë vitit të kaluar Zyra e Burimeve Njerëzore është ballafaquar sfida të shumta. Njëra prej tyre ishte organizimi i punës për shkak se ndërmarrja ka qene e obliguar qe të reduktoj stafin punues për shkak të situatës se krijuar për shkak të pandemisë.

Po ashtu, gjatë vitit të kaluar janë bërë përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e kontrollit dhe monitorimit të punës që punonjësit e kryejnë në ndërmarrje. Për këtë qëllim është instaluar sistemi i ri multifunksional i zyrës së burimeve njerëzore, i cili përmes qasjes online ndikon në ngritjen e cilësisë së punëve në kuadër të departamentit. Sistemi i ri bën kontrollimin e hyrje-daljeve në kohë reale, përdorimin e pushimeve të ndryshme, punonjësve u mundëson ngritjen e kërkesave të ndryshme drejtuar departamentit të burimeve njerëzore.

Zyra e Burimeve Njerëzore përveç punës së rregullt të saj, ishte pjesë e koordinimit të punëve në çështje të ndryshme me interes për ndërmarrjen, që tani kryhen nga

komisione të ndryshme, si p.sh. Komisioni për Paga, Komisioni për Verifikimin e Stazhit të Punës, Komisioni për Shpërblimin e Punonjëseve të dalluar; si dhe ka menaxhuar projektin për furnizimin me uniforma përkatëse të punonjësve në postë të operativës.

Propozime për të ardhmen

Për shkak të punësimeve të ndodhura gjatë viteve 2015 deri në vitin 2018, të planifikuara si dhe sistematizimeve të vendeve të punës në mënyra jo të rregullta të bëra gjatë vitit 2018, është krijuar një situatë mjaftë e vështirë për menaxhmentin, në menaxhimin e punëve në ndërmarrje. Vërehet shume qartë një disproporcion në mes të punëtorëve të nevojshëm në administratë si dhe punëtorëve të angazhuar në sektorin operativ të ndërmarrjes.

Në administratë vërehet që ka punëtorë të shumtë tek të cilët vihet në pah produktivitet mjaft i ulët. Duhet të ceket fakti që vetëm në Departamentin ekonomik – financiar, janë të angazhuar plot 13 punëtorë për të cilët nuk ka punë për angazhim të mjaftueshëm.

Pra, nga ajo që u tha më lartë është e domosdoshme që të bëhet një ristrukturim i vendeve të punës në ndërmarrje me qëllim të ngritjes së produktivitetit të punëtorëve duke balancuar ngarkesat e pozicioneve të punës në operativë vs. administratë, i cili veprim do të ketë ndikim pozitiv në përmirësimin e shërbimeve në ndërmarrje.

5 Financat

NPL “Stacioni i Autobusëve” sh.a Prishtinë, krijon të hyrat nga shërbimet e ndryshme të ofruara me statutin e ndërmarrjes, dhe në këtë mënyrë nuk shpenzon mjete nga buxheti i konsoliduar i Komunës së Prishtinës.

Shërbimet kryesore nga të cilat krijohen të hyrat e ndërmarrjes janë si në vijim:

- Shërbimi i peronizimit – ky shërbim paguhet nga të gjithë auto transportuesit e regjistruar në Kosovë të cilët kanë linja të regjistruara dhe të lejuara nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (MTI), për linjat nder-urbane dhe ndërkombëtare. Cmimorja për këtë shërbim caktohet nga Bordi i Drejtorëve të ndërmarrjes në marrëveshje me shoqatën e autotransporteve të Kosovës dhe me miratim të departamentit përgjegjës në kuadër të MTI-së.
- Shërbimi i parkingut – Ndërmarrja posedon një hapësirë e cila shfrytëzohet për parking të veturave private si dhe autobusëve të ndryshëm.
- Shërbimi i shitjes së biletave – Në marrëveshje me auto transportuesit, ndërmarrja bën shitjen e biletave për linja të ndryshme dhe me këtë rast krijon të hyra përmes shërbimit të shitjes së biletës si dhe provizionit për shitjen e biletës.
- Shërbimi i gardërobës – ndërmarrja ofron shërbimin e ruajtjes së bagazhit dhe në këtë mënyrë krijon të hyra për këtë shërbim.
- Shërbimi i marketingut – ndërmarrja ofron shërbimin e reklamimit për operatorët e ndryshëm ekonomik për reklamimin e bizneseve të tyre, përmes hapësirave reklamuese si dhe reklamimin në ueb faqen e ndërmarrjes.
- Lëshimi i hapësirave afaristë me qira – ndërmarrja në kuadër të hapësirës së saj posedon 29 lokale të cilat i lëshon me qira në baze vjetore dhe nga të cilat krijon të hyra të vazhdueshme mujore.

Me qëllim që ndërmarrja të jetë funksionale ka kosto - shpenzime lidhur me paga dhe mëditje për punëtorë, përfshirë dhe shpenzimet për paga dhe mëditje për anëtarët e bordit si dhe zyrtarët e lartë të ndërmarrjes. Gjithashtu, janë të evidentuara edhe shpenzimet operacionale dhe ato administrative si dhe shpenzimet e amortizimit të

ndërtesës së ndërmarrjes dhe pajisjeve të ndryshme me të cilat funksionon ndërmarrja.

5.1 Të hyrat

51% e të gjitha të hyrave të ndërmarrjes krijohen nga shërbimi i peronizimit. Pra këto të hyra krijohen nga shërbimi i peronizimit i cili paraqet shërbimin kryesor në krijimin e të hyrave të ndërmarrjes të hyra këto që mundësohen përmes operimit të 231 auto transportuesve të ndryshëm të cilët i mbajnë linjat e ndryshme, si ato nder urbanë (linja lokale) njashtu edhe ato ndërkombëtare.

Të hyra tjera me rëndësi, janë edhe të hyrat nga qiratë të cilat paraqesin në total 26% e të gjitha të hyrave totale. Këto të hyra nga qiraja, realizohen nga bizneset dhe aktivitetet e tyre biznesore që zhvillohen në hapësirën e ndërmarrjes. Gjatë periudhës së pandemisë (Mars – Qershor), për dy muaj Prill dhe Maj 2020, gjysma e shumës së qirasë, janë paguar nga Qeveria ndërsa pjesa tjetër, pas kërkesës së qiramarrësve dhe me vendim të bordit të drejtorëve është ulur ndjeshëm për të gjitha bizneset të cilat shfrytëzojnë hapësira me qira në ndërmarrje.

Një pjesë e hapësirës së stacionit shfrytëzohet për parking me pagesë, i cili shërbim paraqet një të hyre të rëndësishme gjithashtu për ndërmarrjen. Gjatë vitit kjo e hyrë paraqet 18% e totalit të hyrave gjatë vitit të kaluar.

Janë edhe shërbimet tjera p.sh shitja e biletave, shërbimi i gardërobës, shërbimi i marketingut të cilat së bashku paraqesin rreth 5% në totalin e të hyrave. Kjo përqindje e vogël në të hyrat totale është si pasojë e kufizimeve të ndryshme të lëvizjes si pasojë e situatës pandemiologjike në vend gjatë vitit të kaluar.

Në vitin 2020, Kuvendi Komunal i Prishtinës ka dhuruar dy herë subvencione në vlerë prej 80,000€, të cilat kanë pas për qëllim mbulimin e kostove për paga si dhe kostove administrative dhe atyre operationale për muajin Prill dhe muajin Maj të vitit 2020.

Duke analizuar të hyrat me vitin paraprak kemi rënie prej 26% tek të hyrat apo janë gjeneruar 259,801.07 € më pak në krahasim me vitin e kaluar.

Të hyrat e realizuara nga këto aktivitete të ndërmarrjes janë të paraqitura në tabelën vijuese:

1- Te hyrat

Përshkrimi	2019	2020
Shërbimi i peronizimit	527,624.95	395,721.24
Shërbimi nga shitja e biletave	47,630.19	6,792.23
Komisioni nga shitja e biletave	30,096.46	19,015.21
Shërbimi i parkingut	182,001.50	136,031.89
Shërbimi i ruajtjes së valixheve (gardëroba)	136.43	-
Qiratë nga lokalet	226,229.56	192,984.07
Te hyra nga marketingu	380.00	1,398.30
Te hyra tjera (p.sh shitja e aseteve jashtë përdorimit)	1,364.81	3,647.86
Totali i të hyrave Euro	1,015,463.90	755,590.81

5.2 Shpenzimet

Kategoritë e shpenzimeve

Shpenzimet e përgjithshme janë të ndara në kategorinë e shpenzimeve për paga dhe mëditje, shpenzimeve operative, shpenzimet administrative dhe shpenzime të dedikuara për investime të nevojshme të cilat janë të domosdoshme për operationet e ndërmarrjes.

5.2.1. Shpenzimet për paga dhe mëditje

Sa i perket shpenzimeve lidhur me paga dhe mëditje në kuadër të ndërmarrjes njihen këto kategori: kompensimi për anëtarët e bordit të drejtorëve, pagat dhe mëditjet për punëtorët e ndërmarrjes përfshirë edhe zyrtarët e lartë, si dhe pagat përcjellëse shtesë të cilat punëtorët i marrin pasi që të përmbushet kushti për pensionim të tyre sipas ligjit në fuqi.

Kompensimi për anëtarët e bordit bëhet sipas vendimit të aksionarëve ndërsa punëtorët tjerë paguhen në bazë të kontratave të punës valide të tyre sipas të cilave bëhet llogaritja e pagës. Përveç pagës bazë, punëtorëve aktiv iu shtohet shujta, në vlerë prej 3€ për çdo ditë pune dhe përvoja e vitëve të punësimit në bazë vjetore ku bëhet përlllogaritja nga 0.5% mbi pagën bazë, për çdo vit të punës. Punëtorët të cilët punojnë gjatë ndërrimit të natës dhe ditëve të vikendit i bëhet përlllogaritja 30% shtesë, si dhe për ditët e punës gjatë festave zyrtare të Republikës së Kosovës përlllogaritën prej 50% shtesë sipas Ligjit të Punës.

Krahasuar me vitin paraprak kemi ulje prej 5% sa i perket këtyre shpenzimeve. Kjo ulje është shënuar për shkak të pensionimit të tre (3) punëtorëve si dhe mos pagesës së shujtës për një periudhë të caktuar kohore për shkak të evitimit të mundshëm të mungesës së likuiditetit financiar të ndërmarrjes, si pasojë e situatës pandemike në vend, ku me të cilin rast ndërmarrja nuk ka qenë operacionale për rreth 3 muaj si dhe përë pjesën tjetër të periudhës së vitit nuk ka funksionuar me kapacitet të plotë për shkak të masave të qeverisë, respektivisht kufizimeve të ndryshme të ndodhura si shkak i pandemisë.

Edhe pse ndërmarrja ka pas të hyra më të ulëta, është arritur të bëhet pagesa për tre (3) ish punëtorë të ndërmarrjes të pensionuar në bazë të aktgjykimeve të gjykatës kompetentë nga tri (3) paga përcjellëse të pagës mesatare të tyre.

Shpenzimet e pagave bruto

2.1 Pagat	2019	2020
Bordi	22,798.67	31,789.44
Zyrtaret e larte	-	-
Administrata/Operativa	806,699.00	756,809.86
Pagat Jubilare	-	-
Totali I pagave	829,497.67	788,599.30

5.2.2 Shpenzime operative

Në shpenzimet operative bëjnë pjesë të gjitha shpenzimet që ndërlidhen me funksionalizimin e mirëfilltë të ndërmarrjes. Në këtë kategori bëjnë pjesë shpenzimet e rrymës, shpenzimet e ujit, shpenzimet e mirëmbajtjes, shpenzime për veturë zyrtare, shpenzime për mirëmbajtje, të energjisë elektrike si dhe shpenzime tjera të paraqitura detajisht në tabelën e mëposhtme.

Gjatë vitit 2020, janë bërë punime shtesë lidhur me ndarjen dhe vendosjen e orëve të rrymës për të gjitha bizneset të cilat operojnë – shrytëzojnë lokalet me qira të cilat gjenden në kuadër të ndërmarrjes. Në anën tjetër këto shpenzime kanë ndikuar që shpenzimet e rrymës të jenë më të vogla në krahasim me vitin paraprak.

Gjatë vitit të kaluar është angazhuar kompania e jashtme për pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të ndërmarrjes. Kostoja për angazhimin e kompanisë kontraktuese ka qenë në vlerën prej 635.00 € në muaj e që në total kap shumën vjetore prej 6,350.00€. Kjo kosto ka vazhduar deri në përfundim të validitetit të kontratës, në fund të muajit mars 2021.

Shpenzim tjetër operativ në vitin 2020 kanë qenë edhe shpenzimet lidhur me mirëmbajtjen e sistemit të digjitalizimit. Ky shpenzim ka qenë për sistemin e laurave dhe sistemin e biletave nga nje kompani e kontraktuar me nje kosto mujore prej 830.50€.

Duke e bërë krahasimin me vitin paraprak kemi ulje të shpenzimeve operative prej 56% apo 77,024.14 €.

Kjo ulje e shpenzimeve është berë përmes një menaxhimi shume rigoroz, përmes kontrollës dhe monitorimit të vazhdueshëm të te gjitha shpenzimeve.

2.2. Kostot operative	2019	2020
Telefonia mobile	737.74	2,352.31
Telefonia Fikse	7,068.08	671.69
Interneti	843.54	813.56
Domeni dhe Ueb faqja	606.66	606.66
Shpenzimet e rrymës	50,131.67	23,674.08
Shpenzimet e ujit	6,011.69	1,337.67
Shpenzime për bartje te mbeturinave	3,898.19	1,686.87
Shpenzime për materiale Sanitare - Higjienike	2,485.06	1,759.30
Mirëmbajtje objektit	36,559.58	6,771.58
Mirëmbajtje e gjeneratorit dhe derivate	419.50	861.42
Mirëmbajtje pastrimi - kompani e jashtme	-	6,350.00
Pjese rezerve për parking dhe laura	-	888.85
Shërbimi I digjitalizimit (laura dhe shoferi)	4,872.89	7,917.30
Pajisje IT	249.83	1,554.80
Tjera	24,446.78	3,988.97
Totali I kostove operative	138,331.21	61,235.05

5.2.3. Shpenzime Administrative

Shpenzimet administrative i përkasin shpenzimeve që lidhen direkt me funksionalizimin amdinistrativ të ndërmarrjes. Në këto shpenzime hyjnë shpenzimet lidhur me automjetin zyrtar, matëriali për zyre, shpenzime të reprezentacionit, mirëmbajtja e softëerit financiar, shpenzime për perkthimin e pasqyrave financiare sipas kërksesës së ZKA-së etj.

Në kuadër të kësaj kategorie është bërë regjistrimi i një rasti gjyqësor, një kontëst i vjetër i trashëguar nga menaxhmenti i kaluar si dhe shpenzimet administrative për pagesat gjyqësore për pagesat e pagave jubilarë të punëtorëve të ndërmarrjes sipas aktgjykimeve të gjykatës kompetentë.

Në krahasim me vitin paraprak kemi rënie të këtyre shpenzimeve në vlerë prej 12,199.43 apo 36% më pak në krahasim me vitin paraprak.

2.3 Kosto administrative	2019	2020
Shpenzime për vetura	2,317.67	814.08
Mirëmbajtje e veturave dhe sigurim	734.23	1,091.39
Materiale për zyre	2,358.04	2,172.30
Reprezentacion (Përfaqësim)	4,954.94	1,926.29
EVP (Edukimi I vazhdueshëm profesional)	-	152.54
Gardëroba për punëtorë	3,616.00	137.24

Shërbimi i printimit dhe fotokopjes	-	948.56
Mirëmbajtje e softuerit financiar	-	1,553.00
Sigurimi i bartjes se parave CIT	4,652.34	1,077.10
Këshilltare dhe përfaqësues dhe përkthim	2,926.00	2,140.95
Material elektrik (zëvendësim I dritave)	-	1,022.41
Shërbime për vlerësimin e vendeve te punës	-	-
Vlerësim për kënaqësinë e konsumatorit	-	845.76
Shpenzime administrative te tjera	12,223.39	7,701.56
Totali I kostove administrative	33,782.61	21,583.18

5.2.4. Shpenzimet Investive

Gjatë vitit 2020 ka vazhduar investimi në ndarjen e njuhësorëve të rrymës për të gjitha bizneset të cilat operojnë si qiramarrës në kuader të ndërmarrjes. Kjo ndarje është bërë me rekomandim të auditorëve të jashtëm të cilët e kanë vendosur si gjetje mos posedimin e orëve të ndara për të gjithë operatorët ekonomik në cilësinë e qiramarrësve në kuadër të ndërmarrjes sonë. Ky investim ka mundësuar që ndërmarrja të ketë kontrollë më të madhe në shpenzimet vetanake të shpenzimit të energjisë elektrike si dha ka mundësuar evitimin e keqpërdorimit të mundshëm të energjisë elektrike. Poashtu, investim tjetër duhet të permendet investimi në hapësirat gjelbeuese të ndermarra në kuadër të ndërmarrjes që ka pasur për qëllim rritjen e hapësirave gjelbëruese me qëllim të përmirësimit të ambientit dhe uljes së ndotjes e cila mbretëron në ndërmarrje.

Tabela e mëposhtme paraqet investimet e bëra:

2.4 Investimet	2019	2020
Përmirësim I hapësirave gjelbëruese	-	1,181.46
Softueri për Arkiva	-	-
Investime te ndryshme ne objekt	-	-
Ndarja e orëve te rrymës	-	12,321.31
Totali I kostove investime	-	13,502.77

5.2.5. Shpenzimet e amortizimit

Shpenzimet e zhvlerësimit për vitin 2020 janë në vlere prej 79,479.24€. Zhvlerësimi i pasurisë së ndërmarrjes bëhet konform ligjit mbi pasuritë joqarkulluese. Ndërmarrja bën tri lloje të zhvlerësimit: me 0 zero që zhvlerësohet toka, 5% klasi i I, që paraqitën ndërtësat dhe 20%. klasi i II, që zhvlerësohen paisjet. Të gjitha asetët e zhvlerësuar kanë jetëgjatësi më të madhe se një vit.

2.5 Amortizimi	2019	2020
Ndërtesa	56,087.53	56,349.76
Pajisjet e zyrave	22,283.88	23,129.48
Vetura	-	0
Totali I kostos se amortizimit	78,371.41	79,479.24

5.2.6. Fitimi (Humbja) para fitimit

Në vitin 2020, NPL "Stacioni i Autobuseve" sh.a Prishtine, ka operuar me një humbje prej 48,808.73€. Këtë humbje e krijon shpenzimi i Zhvlerësimit qe paraqitët në

shumë prej 79,479€, ndërsa nëse llogaritet vetëm shpenzimet dhe të hyrat operacionale dhe subvencionet, atëherë gjatë vitit 2020 është shënuar një fitim operativ në vlerë prej 30,671€.

Të ardhurat /Shpenzimet gjithëpërfshirëse	2019	2020
Të ardhurat gjithëpërfshirëse	1,015,464.93	915,590.81
Shpenzimet gjithëpërfshirëse	1,079,982.90	964,399.55
Fitim / humbje e vitit	-64,5198.00	-48,808.74

6 Çështjet juridike

Procedurat e ndryshme gjyqësore dhe nga Inspektorati i Punës - Departamenti administrativo- juridik gjatë vitit 2020, ka bërë përcjelljen e të gjitha veprimeve dhe aktiviteteve në kuadër të ndërmarrjes me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të mirë duke u bazuar në ligjet e aplikueshëm dhe rregulloret në fuqi.

Gjatë vitit 2020, Bordi i Drejtorëve ka marrë gjithsej 20 vendime ndërsa Kryeshefi Ekzekutiv ka marrë gjithsej 146 vendime për çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me organizimin e dhe funksionalizimin e ndërmarrjes.

Gjatë vitit 2020, janë hartuar dhe miratuar dy rregullore nga bordi i drejtorëve të cilat nuk kanë hyre në fuqi si pasojë e COVID-19. Po ashtu është punuar edhe drafti i rregullores së re lidhur me sigurinë dhe shëndetin në punë e cila rregullore pritet të finalizohet dhe të adoptohet në bazë të ligjeve dhe masave lidhur me pandeminë COVID -19.

Gjatë vitit 2020, zyra ligjore është ballafaquar me 7 lëndë, përfaqësime ose shkresa të ndryshme gjyqësore. Bazuar në aktgjykimet e gjykatave, zyra ligjore e ndërmarrjes ka ndërmarrë hapat e duhura procedurale për t'iu përgjigjur padive, përfshirë edhe ushtrimin të ankesave, në bazë të afateve të parashtruara ligjore. Pas shterjes së të gjitha mundësive ligjore mbi të drejtën e ankesës, gjatë gjithë vitit 2020 kemi pasur vetëm një rast me formë përfundimtare të aktgjykimit. Sipas këtij aktgjykimi të Gjykatës së Apelit, detyrimi i Ndërmarrjes ishte që një punonjëseje tashmë të pensionuar t'i paguheshin tri paga, në emër të shpërblimit jubilar. Ndërmarrja në këtë rast veprroi sipas Aktgjykimit dhe përmbushi detyrimin e saj ligjor.

Po ashtu gjatë vitit të kaluar kemi ankesa dhe vendime të pranuar nga inspektorati i punës me pretendime të shkeljeve të dispozitave apo procedurave ligjore që rrjedhin nga themelimi i marrëdhënies së punës, ku janë të përfshira pozita të larta dhe pozita tjera të nivelit më të ulët në ndërmarrje.

Informacionet shtesë lidhur me lëndët gjyqësore dhe lëndëve të pranuar nga Inspektorati i Punës mund të gjinden në shtojcën 2 të këtij raporti vjetor.

Detyrimet kontigjentë. – Para vitit 2019, ndaj NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a. Prishtinë janë inicuar disa padi të ndryshme lidhur me kompensime dhe kthim në pozita të punës nga ish punëtorët si dhe nga punëtorët aktual të ndërmarrjes me të cilat rastë është ballafaquar ndërmarrja edhe gjatë vitit 2020. Në bazë të informacioneve zyrtare vlera totale e detyrimeve kontigjentë është 10,000 euro.

NPL Stacioni i Autobusëve Sha në Prishtinë ka vënë dy lloje të Detyrimeve kontigjentë për vitin 2020. E para është lëndët gjyqësore, ndërsa tjetra bëhet fjalë për lëndët nga Inspektorati i punës.

7 Transaksionet

Gjatë vitit 2020, janë shënuar 34 transaksione të prokurimit për furnizim me shërbime dhe materiale të ndryshme për nevojat e ndërmarrjes duke respektuar ligjin dhe procedurat e prokurimit publik (LPP) në vlerë prej 50,646.32€.

Transaksionet me vlerë me të lartë kanë të bëjnë me shërbimet e digjitalizimit në vlerë prej 11,328€, pastaj kontrata lidhur me pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave gjelbëruese të ndërmarrjes në vlerë prej 8,991.6€, kontrata për furnizim me material për mirëmbajtje në vlerë prej 4,383.00, furnizimi dhe instalimi i materialeve për rilokiim të njehsorëve elektrik në vlerë prej 4,150.50€.

Po ashtu duhet të përmenden edhe transaksionet sa i përket shpenzimit të energjisë elektrike në vlerë prej 25,399.25, e cila është si pasojë e përdorimit të energjisë elektrike për nxehjen e hapësirave të ndërmarrjes.

8 Shërbimi i transportit dhe shërbimi teknik

8.1 Shërbimi i transportit

Gjatë periudhës të vitit 2020 janë realizuar në total 99,583 nisje, ku prej tyre 86,252, apo 87 % kanë qenë nisje të linjave ndër-urbane dhe 13,331 apo 13% të linjave ndërkombëtare.

Gjatë vitit janë regjistruar edhe 911 linja sezonale.

Për shkak të masave të vendosura nga Qeveria e Kosovës për parandalimin e përhapjes së virusit Covid 19, është ndaluar i gjithë transporti rrugor nga data 16 Mars deri më 18 Maj, ku gjatë kësaj periudhe nuk është shënuar asnjë nisje nga hapësirat e Stacionit të Autobusëve.

Nga 18 Maji kanë filluar të mbahen linjat e reduktuara mirëpo me vendim të Bordit të Drejtorëve për shkak të vështirësive të ndryshme me të cilat janë ballafaquar kompanitë e transportit, kanë qenë të liruara nga pagesa deri më 1 Qershor dhe për këtë arsye nuk kanë qenë të evidentuara në sistemin e ndërmarrjes.

Linjat në relacionet: Prishtinë-Podujevë; Prishtinë-Orllan; Prishtinë-Shajkofc; Prishtinë- Lupç i Epërm; Prishtinë-Sharban; Prishtinë-Vrellë-Golesh, ende kanë vazhduar të mos e shfrytëzojnë ndërmarrjen respektivisht Stacionin e autobuseve si pikënisje të tyre.

Po ashtu edhe disa nisje në relacione të ndryshme, si ato ndërkombëtare dhe relacionet ndër-urbane p.sh.; Prishtinë - Slloveni; Prishtinë - Turqi, Prishtinë - Mitrovicë; Prishtinë - Drenas - Skenderaj janë duke u mbajtur me pikënisje nga pikat të cilat nuk janë të lejuara.

8.2 Shërbimi Teknik

Gjatë periudhës së vitit 2020, janë bërë punë të shumta të cilat ndërlidhen me shërbimin teknik të ndërmarrjes. Përveç punëve të rregullta të cilat përfshijnë mirëmbajtjen e aseteve të ndërmarrjes p.sh. laurat, kabina e pagesave, kabinat e sigurimit, pastrimi i hapësirave të brendshme, leximi i ujëmatësve të qiramarrësve, janë bërë edhe punë të tjera si në vazhdim:

- Ndarja e njehsorëve të energjisë elektrike për qiramarrësit në objektin e ndërmarrjes.
- Është bërë përgatitja teknike dhe punimet përcjellëse për shtimin e dy peronave të ri për auto transportues, si dhe rregullimi i peronit nr. 1 (trotuaret).
- Është bërë rregullimi i hapësirës së njohur si hapësira për nënat me fëmijë
- Gjatë kohës kur ndërmarrja nuk ka qenë funksionale janë bërë meremetime të ndryshme të objektit të ndërmarrjes si dhe punët përcjellëse lidhur me ngritjen e shërbimeve në ndërmarrje. Të gjitha këto punë janë bërë me punë vullnetare nga punëtorët e ndërmarrjes.
- Riparimi i ngrohjes qendrore dhe i rrjetit të ujit në lokalet që shfrytëzohen nga M.I.

- Është bërë ndarja e depos dhe e podrumit.
- Rregullimi i infrastrukturës përcjellëse si dhe hapësirës gjelbëruese.
- Është bërë lyerja e objektit të hapësirës së brendshme si dhe hapësirës së jashtme. Kjo ka qenë po ashtu edhe veprim i cili ka pas për qëllim dezinfektimin e hapësirës së ndërmarrjes.

Rendësi të veçantë i është dhënë edhe mobilierisë urbane. Me mbeturinat të cilat kanë mbete nga rrethojat në ndërmarrje të cilat janë larguar në fillim të vitit 2019, janë rregulluar ulëse për udhëtarë si dhe është bërë meremetimi i ulëseve ekzistuese përmes ndërrimit të pjesëve si dhe lyerjes së tyre.

9 Shërbimi i sigurimit fizik aseteve dhe i laurave

Në sektorin e sigurimit, procesi i punës ka shkuar mirë, pa ndonjë problem të theksuar. Janë vazhduar takimet e rregullta me Policinë e Kosovës, ku është krijuar një bashkëpunim i mirë në sferën e sigurisë dhe problemet e përditshme të cilat i hasim gjatë procesit të punës. Policia e Kosovës ka kërkuar që të rrisin mbulueshmërinë e ndërmarrjes me kamera shtesë për zbardhjen e rasteve të ndryshme si janë: hajnitë, rrahjet, si dhe pengimin në procesin e punës të punëtorëve të ndërmarrjes nga persona të ndryshëm.

Në baze të kërkesës së Policisë së Kosovës është bërë vendosja e kamerave shtesë dhe në këtë mënyrë është bërë rritja e mbulueshmërisë së monitorimit me kamera të sigurisë.

Gjatë periudhës prej 13 Marsit deri me 18 Maj, pra gjatë periudhës kur është bërë ndërprerja e qarkullimit të linjave, janë marrë masa shtesë për sigurimin e ndërmarrjes përmes kujdestarisë së rregullt ku kemi bërë angazhimin e të gjithë punëtorëve meshkuj ndërsa i kemi caktuar në sigurim çdo natë nga 2 persona gjatë një ndërrimi.

Në sektorin e laurave, procesi i punës ka shkuar mirë ku punëtorët kanë qenë në nivel të detyrave të caktuara të punës. Janë regjistruar probleme teknike në laura ku shpesh herë kanë pasur ndikim negativ në procesin e punës. Është raportuar çdo prishje ndërsa shpesh herë kompania e cila është e angazhuar me kontratë për mirëmbajtje është vonuar në intervenimin e rregullimit të defektit.

Problematik mbetet ndriçimi i dobët në pikat siç janë: parkingu i autobusëve dhe në laura ku shpesh herë nuk funksionojnë mirë laurat natën për hyrje daljet e veturave me anë të tabelave.

10 Prokurimi

Gjatë vitit të kaluar, Zyra e Prokurimit ka zhvilluar gjithsejtë 34 procedura dhe aktivitete të prokurimit, me vlerë të përgjithshme prej 50,646.32 eurove. Prej tyre ishin njëzet e një (21) aktivitete me vlera minimale, në shumën totale prej 14,301.42 eurove, gjashtë (6) me vlera të vogla, në vlerë të përgjithshme prej 13,541.20 euro dhe një (1) me vlerë të mesme, me vlerë të përgjithshme prej 11,760.00 euro.

Po ashtu, për shkak të vonesave në kryerjen e punimeve dhe mos plotësimin e kushteve të kontratës janë bërë dy (2) ndërprerje të kontratave dhe është bërë një (1) anulim i tenderit, për arsye të vështirësive financiare të cilat ndërmarrja i ka pësuar shkakun e pandemisë së krijuar.

Lidhur me gjithë procesin e zyrës së prokurimit dhe kontratat e bëra, të bashkangjitur në shtojcën numër 3, e gjeni raportin përmbljedhës.

11 Digjitalizimi dhe TI-ja

Viti 2020 ka qenë mjaft vit i vështirë për departamentin e digjitalizimit dhe teknologjisë informative, edhe pse përkundër të gjitha sfidave objektivat e parashtruara i ka përfunduar me sukses. Realizimi i objektivave është realizuar si në vijim:

Sistemi i Laurave është funksional -Sistemi i menaxhimit të laurave ka qenë funksional deri në fund të kontratës me operatorin ekonomik. Pas përfundimit të kontratës dhe shpalljes së fituesit të ri janë shfaqur probleme të ndryshme në funksionalizimin e sistemit të laurave. Mirëmbajtja është të paktën një herë në javë nga OE i cili është përgjegjës për sistemin. Janë ndërmarr edhe veprime shpesh për përfitim të shërbimit sa më cilësor me ç 'rast janë zëvendësuar instalimet e vjetra të komunikimit të laurave me server dhe nga teknologjia UTP e komunikimit kemi bërë avancimin e komunikimit me kabllim optik dhe janë shkëputur instalimet e vjetra të kabllove.

Sistemi i kamerave është funksional dhe ndihmon ne sigurinë në punë - Sistemi i kamerave, përkatësisht, sistemi i vëzhgimit gjatë vitit 2020, është avancuar dhe janë shtuar kapacitetet në kamera të cilat do të na ndihmojnë në kontrollimin e hapësirave dhe ngritjen e sigurisë. Ne kuadër të modernizimit është bërë edhe futja e instalimeve të kamerave nën tokë si dhe janë shkëputur instalimet e vjetra të kabllove të kamerave nga shtylla në shtyllë, me ç 'rast është ngritur cilësia e vëzhgimit si dhe është larguar pamja e shëmtuar e krijuar si lëmsh i kabllove të shumta.

Punëtorët kanë përkrahje të vazhdueshme në TI - Ndër përgjegjësitë e departamentit të TI-së është edhe përkrahja e vazhdueshme e stafit të SAP në nevojat e përditshme për mbarëvajtjen e proceseve të punës. Departamenti në vazhdimësi i ofron stafit mbështetje për nevojat e tyre, si dhe organizon trajnime për përdorimin e softuerëve aplikativ si, Microsoft Office Outlook, Power Point, Excel dhe Word.

Serveri është funksional dhe shënimet e punëtorëve janë të ruajtura - SAP posedon pesë server, tre prej të cilëve janë pronë e SAP. Jo të gjithë serverët janë të menaxhuar nga departamenti i TI-së, ndërsa në tabelën më poshtë janë të listuar serverët:

#	Përshkrimi i serverit	Qasa operative	Statusi
1	Serveri për menaxhimin e laurave	FARA	Funksional
2	Serveri për menaxhimin e shitjes së biletave	ESPAK	Funksional
3	Serveri për menaxhimin e dokumenteve	SAP/Bilansi/KIT	Funksional
4	Serveri për menaxhimin e e-mailave	SAP/TelKos/Probit	Funksional
5	Serveri për menaxhimin e EEB faqes	SAP/Probit	Funksional

Bëhet planifikim dhe raportim i rregullt lidhur me detyrat dhe të arriturat -Ne kuadër të departamentit bëhet planifikim i rregullt si dhe raportim për kryerjen dhe/apo ngecjen e detyrave. Gjithashtu në kuadër të planifikimeve futet edhe përpilimi i orareve dhe kujdestarive gjatë vikendit.

Punët që nuk janë përfshirë në kuadër të planit vjetor - Duhet nënvizuar fakti se, departamenti i TI menaxhon edhe me aplikacione dhe punë të tjera që nuk janë përfshirë në planin e vitit 2020, e që janë përgjegjësi ekskluzive të TI.

#	Përshkrimi i punëve	Statusi
1	Menaxhimi i WEB faqes se SAP	Ne rregull
2	Menaxhimi i mail serverit dhe komunikimeve	Ne rregull
3	Mirëmbajtja dhe përkujdesja për aplikacionin e HQ	Ne rregull
4	Mirëmbajtja dhe përkujdesja për aplikacionin e Bilanci	Ne rregull
5	Menaxhimi i kontratës për internet me PTK	Ne rregull
6	Menaxhimi i kontratës për internet me Tëlkos	Ne rregull
7	Menaxhimi i kontratës për shërbim të fotokopjes	Ne rregull
8	Mirëmbajtja dhe përkujdesja për aplikacionin e Door Access Control	Ne rregull
9	Mirëmbajtja dhe kujdesi për centralen telefonike	Ne rregull

12 Marrëdhëniet me publikun

Zyra për Marrëdhënie me Publikun (Recepioni, Informata fonike, Informata vizuale) ka vazhduar me njoftim të vazhdueshëm të gjithë partnerët dhe klientët të cilët i shfrytëzojnë shërbimet e NPL "Stacioni i Autobusëve" SH. A. në Prishtinë. Po ashtu është mbajtur kontakt i vazhdueshëm me mediat e ndryshme me qëllim të prezantimit sa më të mirë të ndërmarrjes ne opinionin publik.

Kjo është arritur duke përdorur kanale të ndryshme të vazhdueshme të komunikimit përmes njoftimeve në tabelën e informimit, në Ueb faqen zyrtare të ndërmarrjes, dhe rrjetet sociale duke i përditësuar me informacionet e nevojshme, duke dokumentuar çdo investim, shërbim dhe aktivitet nëpërmjet publikimit të dokumenteve dhe fotografive.

Gjatë vitit 2020, zyra për marrëdhënie me publikun (ZMP) përmes aktivitetit të saj, i është afuar bashkëpunëtorëve dhe qytetarëve duke krijuar marrëdhënie korrekte, të drejtpërdrejta dhe të vazhdueshme përmes mjeteve të komunikimit dhe duke dhënë informacione të nevojshme për të plotësuar kërkesën e një informimi të saktë, përmes:

- Hartimit dhe publikimit të informacioneve;
- Komunikata për medie;
- Informimit, lajmërimin për veprimtarinë e SAP;
- Komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm;
- Publikimit në UEB faqe;
- Publikimit në Rrjetet Sociale;
- Përdorimit të mjeteve teknologjike për informim dhe lajmërim.

Të gjitha informacionet lidhur me aktivitetet e publikuara nga Zyra për Marrëdhënie me Publikun janë të bashkangjitura në shtojcën e këtij dokumenti.

13 Të arriturat në bazë të objektivave dhe planifikimet

Objektivi 1. Shtimi i të hyrave për 20%

Me këtë objektiv parashihet që deri në fund të vitit totali i të hyrave të jetë rreth 200,000 euro më të larta në krahasim me vitin e tanishëm. Në realizimin e këtij objektivi mund të jetë ndihmesë e madhe lëshimi i lejeve për linja të reja nga ministria e transportit dhe infrastrukturës, gjë që pritët të ndodhë në fillim të vitit 2020, si dhe punimet e parapara nga komuna në rregullimin e një rruge të re, e cila do ti pamundësonte autobusët dhe kombit të parkohen në dalje të stacionit dhe do të jenë të obliguar të hynë në stacion. Po ashtu pritët që të ketë një bashkëpunim dhe koordinim më të mirë në mes të institucioneve në mos lejimin e parkimit të autobusëve në vendet të cilat nuk janë të parapara për nisje por të orientohen që nisjet ti bëjnë nga stacioni.

Të arriturat:

Duke pas parasysh situatën e krijuar pas pandemisë COVID -19, me vendim të Qeverisë së Kosovës të gjitha linjat si ato nder urbanë dhe ndërkombëtare janë pezulluar me datën 13 Mars të vitit 2020. Ky vendim ka ndikuar që edhe ndërmarrja të mos jetë operacionale deri me datën 18 Maj, kur kanë filluar operimin një pjesë e operatorëve që të qarkullojnë, por në një numër shumë të vogël për shkak të kufizimeve të qarkullimit në përputhshmëri me masat në fuqi. Prandaj duke u bazuar në këtë fakt objektivi nuk ka mundur realizohet.

Planifikimi për vitin e ardhshëm:

Do të merren të gjitha masat që në vitin e ardhshëm të gjitha objektivat e përcaktuara të realizohen. Por, realizimi i këtyre objektivave do të mund të ndikohet sërish nga gjendja e gjithmbarshme e cila po mbretëron në vend si pasojë e pandemisë së shkaktuar nga COVID -19.

Objektivi 2. Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve ekzistuese në stacion

Menaxhmenti i ndërmarrjes do të fokusohet në përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve në stacion. Përmirësimi i shërbimeve do të rezultojnë në rritjen e të hyrave të ndryshme duke filluar nga shërbimi i peronizimit, shitja e biletave, rritjen e të hyrave nga parkingu i veturave dhe autobusëve si dhe shërbimi i gardërobës pritët të përmirësohet dhe të krijoj të hyra më të larta.

Të arriturat:

Janë ndërmarrë veprime të cilat kanë për qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve me qëllim të rritjes së të hyrave të ndërmarrjes. Në muajin mars është bërë nënshkrimi i marrëveshjes me shoqatën e auto transportuesve të Kosovës, lidhur me nivelimin e çmimeve të peronizimit. Me këtë veprim të hyrat kane filluar të stabilizohen dhe të rritën. Po ashtu është marrë vendim që të gjithë auto transportuesit, pra autobusët të fillojnë të paguajnë pagesën prej një (1) euro për çdo ore shtesë të parkimit të autobusëve pas kohës mbrojtëse të nisjeve të tyre. Është bere nënshkrimi i kontratave me biznese të ndryshme lidhur me promovimin e bizneseve të tyre në ueb faqen zyrtare të ndërmarrjes. Po ashtu me qëllim të përmirësimit të kushteve është bërë shtimi i dy peronave. Duhet të ceket edhe fakti që është bërë edhe ndarja e orëve të rrymës për biznese, veprim i cili do të ul shpenzimet e ndërmarrjes dhe në mënyre indirekte do të ketë ndikim në të hyrat e ndërmarrjes.

Gjatë periudhës deri sa ndërmarrja nuk ka qenë operacionale shkak i pandemisë janë bërë aktivitete të ndryshme, pra punë vullnetare nga punëtorët e ndërmarrjes

në krijimin e kushteve më të mira për partnerët dhe klientët të cilët i shfrytëzojnë shërbimet e ndërmarrjes.

Është punuar në krijimin e mobilitetit urbane pra janë bërë ulëse për udhëtarë të cilat janë bërë nga mbeturinat apo mbetjet e rrethojave të hekurit në ndërmarrje të cilat janë larguar në fillim të vitit 2019. Gjithsejtë janë bërë 10 ulëse, si dhe janë riparuar ulëset ekzistuese ku është bërë pastrimi, lysterja dhe ndërrimi i pjesëve nga druri për ulje dhe mbështetje. Po ashtu janë larguar pengesa të ndryshme të cilat kanë qenë në ndërmarrje dhe kanë penguar lëvizjen e lire të udhëtarëve, si dhe janë vendosura kamera shtesë për sigurinë e gjithmbarshme në ndërmarrje. Është bërë mbulimi i fontanes ekzistuese si opsion me i mire në krahasim me ri funksionalizimin e saj ku duhej të bëhej një investim goxha i madh. Në kuadër të kësaj fontana ekzistuese është shndërruar në një park të vogël me bime dekorative shumëvjeçarë. Është bërë dezinfektimi i rregullt dhe është bërë edhe lysterja e objektit si masë shtesë për dezinfektim. Po ashtu është bërë rregullimi i hapësirës nëna me fëmijë për të gjithë udhëtarët të cilët janë me fëmijë për përdorimin e kësaj hapësire për nevojat e fëmijëve të vegjël.

Me qëllim të përmirësimit të ndriçimit është bërë ndërrimi i ndriçimit ekzistues i cili ka qenë në funksion për më shumë se 30 vite i cili në realitet nuk e ka bërë ndriçimin e nevojshëm. Po ashtu janë vendosur edhe pano të ndryshme ndriçuese në hyrjet kryesore të ndërmarrjes.

Planifikimi për vitin e ardhshëm:

Edhe pse ndërmarrja është në një pozitë jo të mirë financiare e shkaktuar nga pandemia, menaxhmenti dhe punëtorët do të vazhdojnë të përmirësojnë kushtet në ndërmarrje të cilat lidhen ngushtë me përmirësimin e shërbimeve të ndërmarrjes. Në baze të gjendjes momentale të ndikuar nga pandemia është shumë vështirë të bëhet ndonjë planifikim i mirëfilltë për periudhën e ardhshme.

Objektivi 3. Sigurimi i investimeve

Menaxhmenti i ndërmarrjes ka për detyrë sigurimin e investimeve nga faktorët e jashtëm të cilët pritet të ndikojnë në përmirësimin e shërbimeve të cilat do të kenë ndikim direkt në stabilitetin financiar të ndërmarrjes. Në bazë të suksesit në thithjen e investimeve të jashtme pritet që të bëhen investime në: rritjen e numrit të personave dhe personave ndihmës, zgjerimi i kapacitetit ekzistues të parkingjeve për vetura dhe autobusë, zgjerimi dhe modernizimi i sistemit të digjitalizimit ekzistues duke përfshirë edhe shitjen e biletave online, zgjerimi i hapësirave gjelbëruese me qëllim të uljes së ndotjes së ambientit, shenjzimi horizontal dhe vertikal si dhe instalimi i sistemit të ri të ngrohjes qendrore.

Të gjitha këto investime do të ndikojnë pozitivisht në përmirësimin e shërbimeve, rritjen e të hyrave, si dhe përmirësimin e kushteve të punës në ndërmarrje.

Të arriturat:

Duke pas parasysh situatën e krijuar pas pandemisë, ka qenë shumë vështirë që të ndërmerret ndonjë aktivitet sa i përket sigurimit të investimeve. Lidhur me këtë çështje duhet të përmendet fakti që ndërmarrja ka qenë përfituese e dy pakove – ndihmave ekonomike nga ana e Komunës së Prishtinës dy herë nga 80,000 € me qëllim të mbulimit të shpenzimeve të ndërmarrjes.

Planifikimi për vitin e ardhshëm:

Menaxhmenti i ndërmarrjes do të vazhdojë të kërkojë burime të ndryshme të financimit edhe gjatë vitit të ardhshëm. E gjithë kjo do të varet në bazë të situatës

mentale në vend të shkaktuar nga pandemia.

Objektivi 4. Investimi në ngritjen e kapaciteteve të stafit.

Suksesi dhe përshtatshmëria e ndërmarrjes varet nga stafi se sa ata kanë aftësi profesionale që të jenë me fleksibël dhe të përkushtuar në zbatimin dhe përfundimin e të gjitha objektivave të punës. Ndërmarrjes i nevojitet një staf i ngritur profesionalisht dhe me kapacitete të larta në mënyrë që të arrihet përbushja e objektivave. Gjithashtu ky investim do të ndikonte pozitivisht në ngritjen e imazhit dhe reputacionit të ndërmarrjes.

Të arriturat:

Edhe pse është një nga objektivat me rendësi për ndërmarrjen, në fillim të vitit janë organizuar trajnime në teknologji informative, respektivisht në përdorimin e kompjuterit dhe aplikacioneve të ndryshme me rendësi (Outlook, Word dhe Excel) për punë të përditshme nga punëtorët e ndërmarrjes. Këto trajnime janë organizuar nga stafi i brendshëm i ndërmarrjes me qëllim të uljes së shpenzimeve. Pas fillimit të pandemisë, nuk janë organizuar trajnime duke u bazuar në situatën e krijuar pas pandemisë në vend ku shumë punëtorë të ndërmarrjes janë të liruar që mos të vijnë në procesin e punës.

Planifikimi për vitin e ardhshëm:

Për shkak të gjendjes jo të mirë financiare të ndërmarrjes do të vazhdohet me trajnime të cilat mund të ofrohen nga stafi i brendshëm i ndërmarrjes, në periudhën kur kjo do të mundësohet në baze të situatës së pandemisë në vend.

14 Auditimi

14.1 Auditimi i Brendshëm

Pas konkursit të hapur për plotësimin e pozitës së punës të Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm dhe procesit të rekrutimit të facilituar nga Komisioni i Auditimit të ndërmarrjes sonë sipas përgjegjësive që derivojnë nga Ligji për Ndërmarrjet publike, në Prill 2020 ka filluar përgatitja e dokumentit të Planit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2020. Për shkak të kohës së limituar në dispozicion dhe në mungesë të bartjes së kompetencave, raporteve, detyrave të ndryshme nga paraardhësi i pozitës së ZAB, gjatë vitit 2020 sipas planifikimeve të Planit të Auditimit për vitin 2020, janë audituar gjithsej tre departamente në kuadër të ndërmarrjes sonë.

Departamentet e audituara janë;

1. Departamenti i Financave
2. Departamenti i Prokurimit
3. Departamenti i Resurseve Njerëzore

Si rrjedhojë, të gjeturat dhe rekomandimet nga këto auditime janë adresuar me zyrtarët përgjegjës të ndërmarrjes, Kryeshefin Ekzekutiv, zyrtarët e lartë dhe palë të ndërlidhura, që të adresohen në një plan veprimi me qëllim të përmirësimeve të nevojshme.

Për vitin 2021, gjithashtu Plani i Auditimit është mjaft dinamik dhe gjithëpërfshirës, duke listuar departamentet kryesore të ndërmarrjes për auditim të proceseve që njëherësh do të mbështesin identifikimin dhe përmirësimin e devijimeve të mundshme procedurale e ligjore.

Plani i Auditimit për vitin 2021, i aprovuar nga Komisioni i Auditimit në ndërmarrje përfshin, dhe jo vetëm;

1. Departamenti Administrativo – Juridik

2. Departamenti Ekonomiko – Financiar
3. Zyra e Prokurimit
4. Departamenti i Transportit dhe Shërbimit Teknik
5. Sektori i digitalizimit dhe TI

Me aktivitetin e vitit 2021, përmbillet një cikël i përgjithshëm i aktiviteteve të njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe Komisionit të Auditimit, në aspektin e përfshirjes së të gjitha njësive në kuadër të ndërmarrjes sonë.

14.2 Auditimi i Jashtëm

Për shkak të situatës pandemike në vend, sipas obligimeve ligjore dhe rekomandimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit është angazhuar një kompani e jashtme për auditimin e pasqyrave financiare të ndërmarrjes për vitin 2020.

Sipas auditimit të jashtëm, menaxhmenti i ndërmarrjes i kanë kushtuar kujdes implementimit të rekomandimeve nga vitët paraprake.

Gjatë vitit 2020, janë shënuar pese (5) gjetje nga auditori i jashtëm. Raporti final i auditimit është i publikuar ne ueb faqen zyrtare të ndërmarrjes www.sap-rks.com

Shtojca 2: Çështjet Juridike

Lëndet gjyqësore	Data	Nr. i protokollit	Përshkrimi
	19.03.2020	02/736	Parashtrim I padisë për shpifje kundër Sami Ahmetit
	05.06.2020	02/1005	Aktgjykim nga Gjykata Themelore nr.C.1508/17: Refuzohet kërkesë padia e Ahmet Maxhunit.
	16.06.2020	02/1073	Përgjigje ne padinë me nr.C.1516/19 rasti Driton Hasanit.
	07.03.2020	02/1259	Gjykata Themelore Aktvendim – Refuzohet i bazuar 29.12.2004
	13.07.2020	02/1333	Gjykata Themelore, Divizioni Civil, Ankesë.
	19.08.2020	02/1558	Aktgjykim nga Gjykata e Apelit – Delta ing
	14.09.2020	02/1737	Gjykata e apelit për 3 paga jubilarë për Isuf M.
Inspektorati i Punës	Data	Nr. i protokollit	Përshkrimi
	16.07.2020	02/1343	Vendim - I Bazuar- Ankese, Diana Kadriu
	22.07.2020	02/1391	Njoftim lidhur me rastin e Diana Kadriut per IP
	11.08.2020	02/1534	Vendim – I bazuar – Emin Sejdiu
	13.08.2020	02/1545	Ankesë për IP rasti Emin Sejdiu
	02.10.2020	02/1852	Inspektorati i Punës nr.01/12 – 08/20 – Vendim – Anulim i vendimit për sistemimin e punëtorit Sami Ahmeti.
	23.11.2020	02/2170	Tërheqje nga ankesa e palës ankuese – Sadat Krasniqi.
	09.12.2020	02/2288	Dërgese nga Faton Raci.
	09.12.2020	02/2289	Ankese nga Luan Hoti - Shqiptimi I vërejtjes me shkrim – E bazuar
	10.12.2020	02/2306	Kërkesë nga Inspektorati i punës per Veton Demirin.
	15.12.2020	02/2325	Vendim per anulimin e konkursit për pozitën zyrtarit për auditim te brendshëm nga Inspektorati i punës.

Shtojca 3: Kontratat e prokurimit 2020

Raporti I kontratave te prokurimit per vitin 2020

Kontratat me vlerë minimale (100-1000)€		
Nr.	Përshkrimi i Aktivitetit	Vlera
1	Furnizimi dhe Instalimi i Materialeve elektrike për Rialokimin e Njehsorëve elektrik-Furnizim shtesë	€ 783.00
2	Përkufizimi i peroneve të rinjë	€ 560.00
3	Furnizim me anësorë për perona	€ 620.00
4	Furnizim me beton për perona	€ 975.00
5	Shërbime të Fotokopijimit	€ 999.00
6	Furnizim me rrjetë armature për perona	€ 660.00
7	Dezprovizin për Hapësirat e Stacionit	€ 240.00
8	Shërbime Programi për Kontabilitet	€ 982.94
9	Furnizim me Material Elektrik	€ 987.94
10	Furnizimi dhe Montimi me Kamera	€ 959.34
11	Shërbim Vjetor të Internetit Backup Linq	€ 960.00
12	Furnizim me Material Elektrik	€ 992.00
13	Shërbim vjetor për Dezinfektim, Dezinfektim dhe Deratizim në hapësirat e Stacionit	€ 610.00
14	Shërbime për shtypjen e Reklamave ndriçuese	€ 258.00
15	Furnizim me material elektrik për ndriçimin e peronave	€ 692.00
16	Sigurimi Full Kasko për veturë zyrtare	€ 529.72
17	Furnizim me Bimë Dekorative	€ 959.40
18	Shërbime për përkthimin e Pasqyrave Financiare dhe Komente	€ 501.24
19	Furnizimi dhe montimi me pajisje të vëzhgimit	€ 609.82
20	Furnizim me material për sevisimin e gjeneratorit	€ 190.02
21	Furnizim me material për dezinfektim-Covid 19	€ 232.00
Totali I vlerave minimale		€ 14,301.42

Kontratat me vlerë të vogël (1.000-10.000)€		
Nr.	Përshkrimi i Aktivitetit	Vlera
1	Furnizimi dhe Instalimi i Materialeve elektrike për Rialokimin e Njehsorëve elektrik	€ 4,100.50
2	Furnizim me Uji për pije	€ 1,200.00
3	Furnizim me Material për mirëmbajtje	€ 4,383.00
4	Furnizim me material higjienik	€ 1,109.70
5	Shërbime për Vlerësimin e kënaqësisë së konsumatorit	€ 998.00
6	Auditimi i pasqyrave financiare të NPL-së për vitin fiskal 2020	€ 1,750.00
Totali i vlerave të vogla		€ 13,541.20

Kontratat me vlerë të mesme (10.000-125.000)€		
Nr.	Përshkrimi i Aktivitetit	Vlera
1	Ri-Tenderim "Mirëmbajtje dhe furnizimi i sistemit të digjitalizimit"	€ 11,760.00
Totali i vlerave të mesme		€ 11,760.00

Stacioni i Autobusëve Prishtinë

Ndërprerje e Kontratës		
1	Furnizim me Led për Perona dhe Holl	€ 1,088.55
2	Mirëmbajtje dhe furnizimi i sistemit të digjitalizimit	€ 11,328.00

Anulim i tenderit		
1	Furnizim me Shenja të Komunikacionit	

Shtojca 4: Publikimet nga ZMP

ZMP ka bere publikimin e te gjitha aktiviteve, punëve dhe informatave ne interes te bashkëpunëtorëve.

Në Webfaqe gjatë muajit Janar 2020 janë publikuar këto informata:

- Vendim për anulim të konkursit "Zyrtar për auditor të brendshëm" 14.01.2020
- Shpallje e konkursit për "Zyrtar për auditor të brendshëm" 14.01.2020
- Njoftim për "Radhitjen e re të peronave" 23.01.2020
- Ftesë për "Ankand publik vetura KIA" 24.01.2020
- "Hiqen trotualet që pengojnë lëvizjen e udhëtarëve" 20.01.2020
- Vendosja e reklamave te transportuesve ne Web faqe,(Wester Union, Bici Com)
- Ne foto galeri janë bashkangjitur të gjitha fotot e publikuara të aktiviteve.

Punë dhe detyra tjera:

- Takimet javore me menaxhmentin e SAP
- Përfundimi i raportit vjetor 2019 nga ZMP
- Shpallja e konkursit në gazetën Koha Ditore dhe Bota Sot (Zyrtar për auditim te brendshëm)
- Publikimi i konkursit në Web faqen e Komunës së Prishtinës
- Kontaktet me Europrint për vendosjen e re të folie-ve në zyrën e takimeve, 20.01.2020.
- Përcjellja e mbushjeve të numrave telefonik të Valës dhe Ipkos

Në Webfaqe gjatë muajit Shkurt 2020 janë publikuar këto informata:

- Struktura organizative e Stacionit të Autobusëve:
- Komisioni i Aksionarëve
- Bordi i Drejtorëve
- CV, e Kryeshefit Ekzekutiv të SAP
- Linku për bashkëngjiten e orareve të punës
- Linku i bashkëlidhur me Ministrinë e Infrastrukturës për informatat e nisjeve:
- Rendet e udhëtimit ndër urban
- Rendet e udhëtimit ndërkombëtar
- Në foto galeri të bashkangjitura të gjitha fotot e publikuara të postimeve
- Ankand publik për lokalet afariste, 11.02.2020
- Rikthimi i çmimeve të peronizimit, 13.02.2020

Punë dhe detyra tjera:

- Takimet javore me menaxhmenti e SAP
- Takimi me shoqatën e të verbërve dhe bashkëpunimi me ta për përgatitjen e informatave të rendit të udhëtimit ne alfabetin Brajt. 05.02.2020
- Informimi me telefon të transportuesve për përgatitjen e faturës nga ta për pagese nga muaji Shkurt 2020 dhe muajt ne vijim.
- Kontaktet me Europrint për vendosjen e folie-ve në të gjitha lokalet të cilat kanë qasje ne holl të SAP.
- Përcjellja e mbushjeve të numrave telefonik të Valës dhe Ipkos
- Përgatitja e orareve të punës për ZMP

Në Webfaqe gjatë muajit Mars 2020 janë publikuar këto informata:

- Matja e kënaqësisë së konsumatorëve, 05.03.2020
- Anulimi i ankandit për lokalet afariste, 06.03.2020
- Rezultat i ZAB, 09.03.2020
- Nënshkrimi i marrëveshjes së re e çmimeve të peronizimit, 11.03.2020

- Vendimi nga MI dhe Ambientit për dezinfektimin e të gjitha mjeteve transportuese, 12.03.2020
- Komunikatë për media nga SAP, parandalimi i infeksionit me COVID19, 12.03.2020
- Vendimi i pezullimit të përkohshëm të disa linjave nga M.I dhe Ambientit, në të mirë të parandalimit të virusit Corona COVID19, 13.03.2020
- Vendimi i mbledhjes së Qeverisë së Kosovës rreth parandalimit të infeksionit Corona virus , 13.03.2020
- Vendim për lirim nga procesi i punës të disa kategorive të punëtorëve, 13.03.2020
- Task Forca e NPL Stacioni i Autobusëve, përgjegjëse e masave mbrojtëse, kundër Corona Virusit Covid19, 13.03.2020
- Falënderimi për SpitexKosova dhe z. Dukagjin Hysa, për donacion të mjeteve mbrojtëse (200 maska) për punëtorët e SAP, 15.03.2020
- Dezinfektimi i Stacionit të Autobusëve, 12.03.2020.
- Ndërprerët me efekt të menjëhershëm transporti ndër-urban dhe ndërkombëtar i udhëtarëve në Republikën e Kosovës, 14.03.2020
- Pastrimi me shampo i hapësirave të SAP, 17.03.2020 Dhurimi i 10 kontejnerëve nga Komuna e Prishtinës për menaxhimin e mbeturinave në hapësirat e Stacionit, 17.03.2020.
- Ndarja e orave të rrymës në Stacionin e Autobusëve, 20.03.2020

Punë dhe detyra tjera:

- Takimet javore me menaxhmentin e SAP
- Karroce ndihmëse për personat në nevojë, donacion nga Hendikep Kosova, 10.03.2020
- Pajisja e të gjithë punëtorëve të SAP me mjete dezinfektuese, maska dhe dorëza, masa mbrojtëse ndaj infeksionit me virusin COVID19, 10.03.2020
- Intervista në TV dhe portalet lokale.

Në Web Faqe gjatë muajit Prill 2020 janë publikuar këto informata:

- Subvencionimi nga Komuna e Prishtinës-14.04.2020
- Fotografi të qytetit të Prishtinës, -26.04.2020
- Publikimi i informatave Covid Plakata -26.04.2020
- Dita botërore e shëndetit dhe sigurisë në punë, 28.06.2020
- Punët vullnetare në SAP në kohë të pandemisë

Punët dhe detyrat tjera:

- Takimet javore me menaxhmentin e SAP
- Raportimet javore të ZMP
- Raportimi për detyrat në muajin Prill 2020
- Mbushjet në VALA&IPKO

Në Web Faqe të SAP gjatë muajit Maj 2020 janë publikuar këto informata:

- 1 Maji dita ndërkombëtare e punëtorëve, 01.05.2020
- Publikimi i fotove të punëve vullnetare nga koleget e SAP, 04.05.2020
- Publikimi i lajmit nga Ekonomia Online
<https://ekonomiaonline.com/nacionale/ska-lirim-te-peronit-per-autobuse-stacioni-i-autobuseve-ben-perqatitjet-per-te-filluar-punen/>, 16.05.2020

- Publikimi i lajmit nga <https://indeksonline.net/%e2%80%8bdeshton-transporti-nderurban-transportusit-skane-llogari-te-punojne-me-pak-udhetare-1/?fbclid=IwAR2iITZYGpJ->, 20.05.2020
- Publikimi i lajmit per mbajtjen e linjave te reduktuara me lirimin e masave, 21.05.2020
- Publikimi i lajmit nga https://fakteplus.net/rritet-qarkullimi-i-autobuseve-nga-gytetet-e-kosoves-per-ne-prishtine-ata-po-punojne-me-humbje/?fbclid=IwAR3Q2_evSQzkTPwVhGHXDtKGiXSG9MA5gjQrD0X411Fum mBpb0YkFFQw32A, 27.05.2020
- Lirimi i përkohshëm nga pagesa e peronizimit, 27.05.2020
- Reagim ndaj shkrimit në indeksonline, 27.05.2020
- Intervista e KE <https://www.youtube.com/watch?v=xJ2CA7m3V0I&fbclid=IwAR1PBEVNue6962PfRrGjOZBx8bfu13ulbKT7YsApgAJlV807A4634Y-X1qg&app=desktop>, 27.05.2020
- Ndryshimi i orarit te punes ne SAP, 28.05.2020
- Publikimi i intervistave <https://ekonomiaonline.com/nacionale/vendimi-per-mospagesen-e-peronit-shfuqizohet-me-1-qershor-kompania-kerkon-ndihmen-e-komunes/https://ekonomiaonline.com/nacionale/shogata-e-transportit-rrugor-mirepret-vendimin-per-lirim-nga-pagesa-e-peronit/>, 29.05.2020

Punët dhe detyrat tjera:

- Takimet javore me menaxhmentin e SAP
- Raportimet javore te ZMP
- Mbushjet ne VALA&IPKO

Në Web Faqe të SAP gjatë muajit Qershor 2020 janë publikuar këto informata:

- Raporti vjetor për kontratat e nënshkruara publike Janar-Maj2020, 02.06.2020
- Statuti i NPL Stacioni i Autobusëve ne Prishtine, 05.06.2020
- Reklame - 1 mujore "Vëllezërit Thaqi" ,16.06.2020
- CV e KE, 26.06.2020
- Raporti vjetor 2019,24.06.2020
- Reklame -1 vjeçare nga Qazim Berisha "Nisa Reisen",30.06.2020

Punët dhe detyrat tjera:

- Takimet javore me menaxhmentin e SAP
- Raportimet javore te ZMP
- Mbushjet ne VALA&IPKO
- Komision disiplinor rasti i iniciuar nga Lirije Krasniqi ndaj Lulzim Hazirit
- Komision për pranimin(furnizimin) me bime dekorative
- Menagjere për mbikëqyrje dhe implementimin e Kontratës " Shërbime për vlerësimin e kënaqësisë së konsumatorit", 03.06.2020.

Në Web Faqe gjatë muajve Korrik-Gusht-Shtator 2020 janë publikuar këto informata:

- Vendosja e logos së Komunës së Prishtinës në Webfaqe të SAP,07.07.2020
- Raporti i auditimit për vitin 2019, 28.07.2020
- Rregullimi i hapësirës "Nënat me fëmije të vegjël", 27.07.2020
- Raporti i hulumtimit të kënaqshmërisë së konsumatorëve,24.07.2020
- Ankand publik, dhënia e hapësirave/lokaleve me qira, shitja e veturës se përdorur, 03.08.2020

- Reklame dhe marketing, Transportuesi Dubova Reisen, reklame 1 vjecare, 31.08.2020
- Biznes Plani, 07.09.2020
- Vendimi i ndryshimit të orarit të punës, 14.09.2020
- Rifreskimi i informatave për shërbimin e Garderobës, 14.09.2020
- Ndryshimi i orarit të punës në vendet e publikuara, 14.09.2020
- Sqarimi rreth artikullit të publikuar ne media: Koha.net, Periskopi, Kosovapress, 24.09.2020.

Në Web Faqe gjatë muajve Tetor, Nëntor, Dhjetor 2020 janë publikuar këto informata:

- Konkurs i brendshëm për pozitën: Administrator për evidence dhe udhëheqje të mjeteve themelore, 14 Tetor 2020
- Solidarizimin në muajin e parandalimit të kancerit të gjirit. Tetor 2020
- Ftesë për ankand publik (Dhënia e hapësirave, lokaleve me qira dhe shitja e automjetit të përdorur), 19 Tetor 2020
- Ftesë për shprehje të interesit për institucionet mikro-financiare të licencuara, 19 Tetor 2020
- Njoftimi për kontratë lidhur me Auditimi i jashtëm i pasqyrave financiare të NPL-së për vitin fiskal 2020, 4 Nëntor 2020
- Konkurs i brendshëm për pozitën: Teknik i Transportit, 04 Nëntor 2020
- Ftesë për ankand publik (Dhënia e hapësirave, lokaleve me qira), 27 Nëntor 2020
- Linja e re për Viti (Endriti tours), 02 Nëntor 2020
- Intervista në T7, 01.Tetor 2020
- Intervista në KTV, 14 Tetor 2020
- Nga syri.net. https://www.syri.net/syri_kosova/ekonomi-lajme/178021/ja-si-u-perjetua-pandemia-ne-stacionin-e-autobuseve-ne-pishtine-rrefen-luan-hoti/
- Nga lajmi.net, <https://lajmi.net/linjat-nderkombetare-te-autobuseve-ende-te-bllokuara-360-te-tjera-jane-ne-qarkullim/?fbclid=IwAR0X0YfNt-tKTYQVU9iXjKfSKLcEzEjfpvQdhjDCGEdVq7hbxcntKfkHYk>
- Rifreskimi dhe përgatitja e numrave kontaktues të transportuesve dhe bashkëpunëtorëve për sportelin Informativ, 07 Dhjetor 2020
- Informata shtese për udhëtarët në Webfaqe, për restorantet, lokalet, shitoret me pakice, taxi etj, që mund ti kenë në shfrytëzim në SAP, 07 Dhjetor 2020
- Kemi postuar më shumë se 70 fotografi në rrjetet sociale dhe në Webfaqe.
- Rreth 208 përgjigje- informata i kemi dhënë gjatë këtij tremujori vetëm në Messenger, rreth orarit të nisjeve për linjat nder urbanë dhe ndërkombëtare.
- Nënshkrimi i marrëveshjes me UnionNet për pagesat e shërbimeve të ndërmarrjes sonë në të gjitha pikat e UnionNet në Kosovë, 01 Dhjetor 2020